**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA**
**KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN**

**Drejtoria Komunale për Prokurim Publik**
VU644-24-8442-5-1-1/C971
14 Nr. 926/24
Dt. 31.10.2024

# KONTRATË PUNE

**Palët kontraktuese :**

1. Komuna e Vushtrrisë, si autoritet kontraktues, të cilën e përfaqëson **z. Ilmi Azemi** - Drejtor i Drejtorisë Komunale për Prokurim Publik (në tekstin e mëtejmë **PORORSITËSI)** , dhe

2. **Grupi i O.E. : " Bujar Shabani B.I. "emri i biznesit/ NPSH " Bageri "emri tregtar, me ARBK: 810644197, me seli në Ferizaj** & " Famiz CO-HC "sh.a. emri i biznesit, me ARBK : 810628399, me seli në Suharekë & " Burim Zabelaj B.I" emri i biznesit/ " NNSH " World Medium "emri tregtar, me ARBK: 811152941, me seli në Malishevë, të cilët i përfaqëson **z. Bujar Shabani** , në tekstin e mëtejmë: **KRYESI I PUNËVE**

, janë pajtuar të lidhin një kontrate publike për pune e shënuara me poshtë: **Rehabilitimi i rrugëve Akrashticë – Balincë, i rrugës nga Maxhistrala N Dumnicë e Ulët-Dumnicë e Epërme, rehabilitimi i rrugës Dëshmorët e Kombit në Vushtrri dhe projekti R220 nga ura e lumit Silnica deri te Llamkosi**

**Lot. 1 – Rehabilitimi i rrugëve në fshatrat Akrashticë - Balinc, L=4060M; b=5-4m'** , me numër identifikues:

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Nr. i Prokurimit** | **VU644** | **2** | **4** | **84** | **4** | **2** | **5** | **1** | **1** |
| **Nr. i brendshëm** | **VU644** | **2** | **4** | **0** | **7** | **7** | **5** | **1** | **1** |

**Neni 1 Lënda**

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve nga ana e Kontraktuesit dhe ka të bëjë me sa vijon : **rehabilitimi i rrugëve në fshatrat Akrashticë - Balinc, L=4060M; b=5-4m'**, sipas dokumentacionit standard dhe Specifikimit Teknik të ofertës me : **Nr. i prokurimit : VU644-24 – 8442-511 / Nr. i Brendshëm : VU644-24-077-511**
- **Afati i fillimit të punimeve është** 5 ( pesë ) ditë pas nënshkrimit të kontratës, në rast se kushtet klimatike vlerësohen të përshtatshme për punë.

1.2 Afati i përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë : sipas afatit të përcaktuara në Kushtet e Veçanta të Kontratës, jo më gjatë se **30 Nëntor 2026** nga data e fillimit të punimeve.**( projekt tre vjeçar 2024 – 2026 )**

1.3 Kryesi i punimeve ka të drejtë në shtyrje të afatit të kryerjes së punimeve në rast të ndikimit të fuqisë madhore, vonesës së Porositësit në përmbushjen e obligimeve kontraktuese dhe atë për aq ditë sa kanë zgjatur rrethanat që e kanë shkaktuar vonesën.

1.4 Punëdhënësi, menjëherë pas lidhjes së kësaj kontrate, do të emëroi Menaxherin e Kontratës - Projektit si dhe Mbikëqyrësin e Drejtpërdrejtë të Menaxherit të Kontratës duke i përcaktuar edhe përgjegjësitë dhe detyrat lidhur me realizimin e kësaj Kontrate dhe ekzekutimin e punimeve sipas projektit.

1.5 Punëmarrësi obligohet që, në kërkesë me shkrim të Punëdhënësit apo organit të autorizuar prej tij, të kryej edhe punë tjera shtesë të paparapara lidhur me projektin në fjalë, por që nuk do të filloi me punimet shtesë përderisa me Punëdhënësin nuk arrihet marrëveshje- aneks kontratë me shkrim për të specifikuar punët dhe çmimin.

1.6 Vetëm Autoriteti Kontraktues mundë ti miratoi ndryshimet, modifikimet, shmangiet dhe zëvendësimet në Përshkrimin e Punës, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi që rregullojnë këto çështje.

1.7 Punëmarrësi ka të drejtë në shtyrje të afatit të kryerjes së punimeve në rast të ndikimit të fuqisë madhore, vonesës së Punëdhënësit në përmbushjen e obligimeve kontraktuese dhe atë për aq ditë sa kanë zgjatur rrethanat që e kanë shkaktuar vonesën.

1.8 Punëmarrësi do të penalizohet me shumën prej 0,10% të vlerës së kontratës për çdo ditë vonesë të pajustifikuar të kryerjes së punëve të papërfunduara, por që ky dënim, në asnjë mënyrë, të mos mundë të tejkaloi shumën prej 10 % të vlerës së përgjithshme të kontraktuar.

1.9 Punëmarrësi, pas përfundimit të procedurave të pranimit teknik të punimeve, përmes **afatit garantues i cili nuk mundë të jetë më i shkurtë se 2 ( dy ) vite** , e siguron Punëdhënësin se punët dhe detyrat e besuara janë kryer me një cilësi të lartë dhe sipas konditave të përcaktuara me projekt dhe sipas dispozitave të LMD-së që rregullojnë këtë çështje.

1.10 Garantimi i cilësisë së punëve nga ana e Punëmarrësit do të bëhet në afatin dhe në institucionin e përcaktuar si në Kushtet e Veçanta të Kontratës, pjesë e dosjes së tenderit.

1.11 Afati garantues fillon nga dita e pranimit teknik të përkohshëm të objektit.

1.12 Punëmarrësi obligohet që, brenda afatit kohorë garantues, me ftesë- kërkesë të Punëdhënësit t'i eliminoi, me shpenzime të tija, gjitha të metat eventuale të shfaqura në objekt me fajin e tij dhe atë në afatin prej 5 ditësh pune nga dita e dërgimit të ftesës.

1.13 Në rast se Punëmarrësi në afatin e paraparë nuk i ndërmerr veprimet për eliminimin e të metave, Punëdhënësi të metat e paraqitura do ti eliminoi përmes angazhimit të një punë kryesi tjetër, e në barrë të Punëmarrësit, duke shfrytëzuar mjetet financiare të depozituara me Garancion të Sigurimit të Cilësisë.

1.14 Punëmarrësi nuk do të përgjigjet për të metat e shfaqura si pasojë e shfrytëzimit – përdorimit jo adekuat të objektit të pranuar. Me këtë rast për bazë do të mirën dispozitat e LDM-së që rregullojnë këtë çështje.

1.15 Gjatë kryerjes së punimeve do të udhëhiqet libri ndërtimorë dhe ditari i punës sipas normave ligjore në fuqi, ndërsa Punëdhënësi apo organi i autorizuar prej tij do ti vërtetoi punimet e kryera sipas dinamikës, konformë specifikimit në para masë , para llogari dhe planin dinamik të punëve.

**Neni 2 Çmimi**

**2.1** Çmimi total i punëve duhet të jetë: **937,996.10€ ( nëntqindtridhjeteshtatmijnënqindnëntdhjetegjashtë/10Euro).**

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

**2.3 Ashtu sikurse është rregulluar edhe me dispozita të Kushteve të Veçanta të Kontratës pjesë e dosjes së tenderit, duke qenë se projekti si në nenin një të kësaj kontrate është projekt afatgjatë ( trevjeçarë) ndërkaq, realizimi në tërësi i projektit nxitë ngritjen e obligimeve financiare të Autoritetit Kontraktues – Punëdhënësit – Komunës së Vushtrrisë dhe Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës që duhen përmbushur nga përvetësimet e viteve të ardhshme fiskale 2025 dhe 2026, bazuar dhe në Planifikimin buxhetor të Komunës së Vushtrrisë dhe të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për vitet në vijim, palët kontraktuese pajtohen që dinamika e realizimit të punëve në projektin në fjalë të realizohet në harmoni me dinamikën e përvetësimeve të mjeteve financiare sipas viteve, në pajtim me pjesën e lëndës së kontratës – pjesë e dosjes së tenderit me Nr. prokurimi : VU644-24 – 8442-511 / Nr. i Brendshëm : VU644-24-077-511 , respektivisht dinamika e realizimit të projektit , sipas viteve 2024 , 2025 dhe 2026 do të realizohet sipas shumave dhe afateve, me sa vijon :**

**- në vitin 2024 nga buxheti i A.K. do të sigurohen ( zotohen ) mjete financiare në shumë prej : 45,000.00€ duke mos përjashtuar mundësinë që AK. të siguroi edhe mjete tjera nga fondi për bashkëfinancim të projekteve dhe / ose mjete nga mjetet e redestinuara nga mbetjet e projekteve të realizuara,**

**- në vitin kalendarik 2025, nga buxheti i A.K., do të sigurohen ( zotohen ) mjete financiare në shumë prej : 350,000.00€ , ndërsa**

- në vitin kalendarik 2026 , nga buxheti i A.K. , do të sigurohen ( zotohen ) mjete financiare në shumë prej : 369,496.10€

Ndërsa,

- nga Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në pajtim me Memorandumin e Mirëkuptimit për financimin e projekteve infrastrukturore nr. 1243/24 dt. 22.07.2024 ( nr. i protokollit të ministrisë / dhe ose nr. 4655/24 dt. 16.07.2024( nr i protokollit të Komunës s Vushtrrisë ) do të sigurohen mjetet financiare , sipas viteve dhe në shumën, me sa vijon :

- në vitin 2024 do të sigurohen ( zotohen ) mjete financiare në shumë prej : 50,000.00€,

- në vitin kalendarik 2025 do të sigurohen ( zotohen ) mjete financiare në shumë prej : 61,750.00€ , ndërsa

- në vitin kalendarik 2026 do të sigurohen ( zotohen ) mjete financiare në shumë prej : 61,750.00€

2.4 Në pajtim me Kushtet e Përgjithshme dhe /ose të Veçanta të Kontratës, pjesë e dosjes së tenderit me : Nr. prokurimi : VU644-24 – 8442-511 / Nr. i Brendshëm : VU644-24-077-511 , mjetet financiare në shumë prej : 37,519.85€, që është e barazvlefshme me 4% të vlerës së përgjithshme të kontratës, Kryesit të Punëve do t'i paguhen në formë paradhënie , në gjiro llogari të tij, pasi të jetë deponuar Sigurimi i paradhënies në shumë të paradhënies, nga një Kompani e Sigurimeve apo bankë të licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës ( BQK ). Kryesi i Punëve këto mjete do t'i shpenzon me destinim të veçantë, përgatitje për fillimin e punimeve ( blerje të materialeve të nevojshme për realizimin me sukses të punimeve sipas Kontratës dhe / ose Projektit, respektivisht realizimin me sukses të punimeve të parapara me Planin për Menaxhimin e Kontratës që duhen përfunduar në vlerën e paradhënies. Kontraktuesi duhet të dëshmoj se pagesa e paradhënies është përdorur në këtë mënyrë me dorëzim të kopjeve të faturave ose dokumenteve të tjera për Menaxherin e Kontratës – Projektit të Autoritetit Kontraktues.

2.5 Paradhënia do të paguhet ( kompensohet ) duke zbritur shuma proporcionale nga pagesat e Situacioneve sipas përqindjes se parapagimit të dhënë nga Komuna e Vushtrrisë, e cila nuk duhet të jetë më e ulët se 20% të vlerës së saktësuar në Situacionin për pagesën e punëve të përfunduara, të cilat paraprakisht janë saktësuar nga Menaxheri i Kontratës i Autoritetit Kontraktues.

2.6 Pagesat financiare do të bëhen : në pajtim me Situacionet e aprovuara nga Menaxheri i Kontratës dhe Mbikëqyrësi i Drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës i Autoritetit Kontraktues.

2.7 Pagesa e fundit do të kryhet pasi Kontraktuesi të ketë përfunduar punimet dhe Komisioni i Pranimit Teknik të ketë lëshuar Raportin për pranimin teknik të punimeve të përfunduara, me Situacion të nënshkruar nga Menaxheri i Kontratës dhe Mbikëqyrësi i Drejtpërdrejt i Menaxherit të Kontratës i Autoritetit Kontraktues.

**Neni 3 Pranimi teknik i objektit**

**3.1** Pas përfundimit të punimeve Punëmarrësi do të kërkoi pranimin teknik të përkohshëm të objektit të përfunduar, ndërsa Punëdhënësi do të zbatoi procedurat e pranimit teknik të përkohshëm të objektit dhe atë nga momenti kur Menaxheri i Kontratës dhe Mbikëqyrësi Drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës i Punëdhënësit e njoftojnë, me shkrim, Punëdhënësin mbi përfundimin e gjitha punëve të parapara.

**3.2** Në pajtim me Kërkesat e saktësuara si ë Kushtet e Veçanta të Kontratës, Punëmarrësi do të depozitoi Sigurimin e Kualitetit të Punëve në shumë prej 10 % të vlerës së përgjithshme të kontratës, **për një periudhë garantuese të defekteve prej 2 ( dy ) viteve** nga data e pranimit teknik të përkohshëm në emër të shumës së mbajtje së parasë.

**Neni 4 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës**

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

(a) Marrëveshja e kontratës;
(b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
(c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
(d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
(e) Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);
(f) Plani për menaxhimin e kontratës;
(g) Procesverbali i mbledhjes së informatave/vizitës se vendit
(h) Dhe dokumente tjera të cilat vlerësohen të nevojshme të jenë pjesë e kësaj kontrate.

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.
4.3 Në rast të paqartësisë apo mospërputhshmërisë lidhur me dispozitat e kësaj kontrate, palët do ti marrin për bazë dispozitat e përcaktuara si në Kushtet e Përgjithshme dhe / ose të Veçanta të kontratës si dhe dokumentacionin pjesë përbërëse e dosjes së tenderit me **nr. prokurimi : VU644 – 24 – 8442 – 5-1-1 dhe Nr. të brendshëm të prok. VU644 – 24 – 077 - 511**
4.4. **Kontestet eventuale lidhur me dispozitat e kësaj kontrate palët do t'i zgjedhin me marrëveshje, në të kundërtën, kompetent për zgjidhje të kontestit do të jetë Gjykata Komerciale në Prishtinë ( Departamenti për Çështje Ekonomike ), ndërsa për bazë do të merren dispozitat e përcaktuara si në dokumentacionin – Dosjen e Tenderit me nr. prokurimi : VU644 – 24 – 8442 – 5-1-1 dhe Nr. të brendshëm të prok. VU644 – 24 – 077 - 511**

**Neni 5 Komunikimet**

**5.1** Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.
**5.2** Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.
**5.3** Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj "ose"vendosë "do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.
**5.4** Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe[1] në katër origjinale, tri prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

| Për Autoritetin Kontraktues<br>Komuna e Vushtrrisë | | Për Kontraktuesin :<br>**NPSH " Bageri "** & " Famis CO-HC "sh.a. & " NNSH " World Medium " me seli në Ferizaj |
|---|---|---|
| Emri : Ilmi Azemi | Emri : Ferit Idrizi | Emri : Bujar Shabani |
| Pozita : drejtor | Pozita : Kryetar i Komunës | Pozita : drejtor |
| Nënshkrimi: | Nënshkrimi: | Nënshkrimi: per: |
| Data: 31.10.2024 | Data: 31.10.2024 | Data: 31.10.2024 |
| v | v | v.v. |

[1] Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

# KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: **VU644-24-8442-5-1-1/C971**

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

| Kushtet e Përgjithshme të Kontratës | | Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK |
|---|---|---|
| Përshkrimi i nenit | Neni. Nr. | |
| Ligji i zbatueshëm dhe gjuha | 2.1 | Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë : **Ligji në fuqi në Republikën e Kosovës.** |
| | 2.2 | Gjuha e përdorur do të jetë : **gjuhët zyrtare në vend.** |
| Siguria e ekzekutimit | 10.1 | Shuma e sigurisë së ekzekutimit është : **Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit është Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit është 10 % e vlerës se kontratës me kohëzgjatje deri me 10.12.2026 ditve nga data e nënshkrimit te kontratës Dokumenti - Polisa e sigurimt apo dokument banka të lëshuar nga ndonjë kompani e sigurimeve apo bankë të licensuar nga Banka Qendrore e Kosovës me afat validiteti për kohëzgjatjen e periudhës deri me 10.12.2026 nga data e nënshkrimit të kontratës.** |
| Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit | 11.2 | Shuma minimale e sigurimit do të jetë:<br>(a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 te KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit te kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë;<br>(b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre;<br>(c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar.<br>(d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje:<br>(i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar<br>e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar |
| Programi | 12.1 | Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda **2 ( ditë )** ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës. |
| | 12.2 | Periudha për Programin e azhurnuar është: konform planit dinamik të dorëzuar sipas afatit të përcaktuar paraprakisht në pikën II.3 të Njoftimit për Kontratë |
| Fillimi i punëve | 17.1 | Data e fillimit do të jetë : 4 (katër) ditë nga data e nënshkrimit të kontratës, në rast se kushtet klimatike vlerësohen të përshtatshme për punë. |

| | | |
|---|---|---|
| | 17.2 | Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë : sipas Planit Dinamik , por jo më gjatë se afat i përcaktuar paraprakisht në pikën II.3 të Njoftimit për Kontratë.<br>- Fillimi i punimeve: 4 (katër) ditë nga data e nënshkrimit të kontratës në rast se kushtet klimatike vlerësohen të përshtatëshme për ekzekutimin e punimeve dhe do të përfundojn sipas planit dinamik të saktësuar në nenin 5.2 të Fletës të dhënave të Tenderit (FDT).<br>- Projektet pjesë të kësaj lënde janë 3 (tri) vjeçare dhe do të realizohen në vitet 2024; 2025 dhe 2026, në të cilat punët do të realizohen në kontinuitet dhe atë sipas përvetësimeve të mjeteve financiare për secilin LOT dhe atë si vijon:<br><br>LOT1 - Projekti është 3 (Tre) vjeçar, vlera e Kontratës është : **937,996.10€€** financimin e të cilit e bënë MMPHI dhe komuna e Vushtrrisë dhe do të realizohet sipas përvetësimeve financiare të saktësuar sipas Marrëveshjes ër Bashkëfinancim të projektit dhe të definuara në Kontratën Bazë. |
| Dëmet e likuiduara | 19.1 | Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë: 0,10 % të çmimit përfundimtar të Kontratës, për ditë të vonuar.<br><br>Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës. |
| Regjistri i punës | 20.1 | Kontraktuesi – Kryesi i Punimeve dhe Menaxheri i Projektit i Autoritetit Kontraktues do të mbajnë Ditarin e Punës dhe Librin Ndërtimor, gjatë gjithë kohës së ekzekutimit të kontratës, për të evidentuar të gjitha përshkrimet e punimeve të ekzekutuara në terren,. për të konfirmuar sasinë dhe cilësinë e materialeve të përdorura në objekët – vend punishte, gjithashtu për të evidentuar ecurinë e punimeve, pengesat eventuale, aktivitetet e ndërmarra për eliminimin e pengesave të shfaqura, kohëzgjatjen e kohës sa kanë zgjatur pengesat dhe në fund, pas përfundimit të punimeve, për të dhënë një Rekapitulim të ecurisë së punimeve përmes të dhënave në shifra dhe data. |
| Inspektimi dhe testimi | 22.1 | Menaxheri i Projektit:<br><br>1.Komuna emëron projekt menaxherin/organin mbikëqyrës per realizimin e projektit si dhe komisionin per inspektimin final te punimeve /pranimin teknik ne te ciklin komisioni duhet te jete ne anëtar nga MMPHI<br><br>2.Projekt mëngjër /organi mbikëqyrës me përgjegjësi te plot vërteton sasinë dhe kualitetit e punëve/furnizimeve te kryera ne baze te cilave OE lëshon dokumentin financiar me kërkesën per pagesën e punëve te kryera ne baze te kushteve te kontratës. |
| Pagesa | 24.1 | Pagesa do të kryhet sipas realizimit të punëve në terren, respektivisht stacioneve të aprovuara nga Menaxheri i Kontratës i Autoritetit Kontraktues.<br><br>Pagesa do të kryhet në afatin sa më të shkurtër kohor, por jo më gjatë se 30 ditë nga data e pranimit dhe evidentimit të faturës nga zyrtari përgjegjës për pranimin dhe protokollimin e faturave i AK-së. |

| | | |
|---|---|---|
| Parapagimi | 26.1 | Komuna e Vushtrrisë do të bëjë pagesë paradhënie Kontraktuesit në baze të Ligjit 08/L-193 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2023 Neni 13 pika 4 nga data e caktuar nga Projket Menaxheri kundër dispozitës nga Kontraktuesi i një Garancioni të Pakushtëzuar Bankar në një formë të pranueshme për Autoritetin Kontraktues në sasi dhe valutë të barabartë me parapagim. Garancia do të mbetet në fuqi deri sa të bëhet pagesa e fundit dhe te kompletohet shuma e parapagimit te dhëna.<br><br>Shuma e garancisë duhet të reduktohet në mënyrë progresive nga shuma që paguhet nga Kontraktuesi. Interesi nuk do të paguhet për parapagim.<br><br>Shuma e parapagimit është 4 % i vlerës se kontratës per lot I<br><br>Kontraktuesi do të përdorin parapagimin vetëm për të paguar Pajisjet, materialet dhe shpenzimet e tjera të nevojshme posaçërisht për kryerjen e punëve.<br><br>Kontraktuesi duhet të dëshmoj se pagesa paradhënie është përdorur në këtë mënyrë me furnizim të kopjeve të faturave ose dokumenteve të tjera për Menaxherin e Projektit.<br><br>Parapagim do të paguhet duke zbritur shuma proporcionale nga pagesat sipas përqindjes se parapagimit te dhënë nga Komuna e Vushtrrisë |
| Mbajtja e Parasë | 27.1 | Shuma e parave të mbajtura është: **N / A** |
| Shkaqet për kompensim | 30.1 | Data e posedimit të vend punimit do të jetë : **deri me datë 30.11.2026** , duke filluar pas nënshkrimit të kontratës dhe fillimit të punimeve, konform Planit dinamik por jo më gjatë se Plani dinamik i përcaktuar në pikën II.3 të Njoftimit për Kontratë. |
| Përgjegjësia mbi Defektet | 34.5 | Periudha garantuese e defekteve është : **Periudha garantuese e defekteve është 2 vite, duke filluar nga data e pranimit teknik të përkohshëm, në shumë prej 10 % të vlerës së përgjithshme të kontratës, për defektet e paraqitura në objekt.**<br><br>**Dokumentit - Policës së Sigurimit të kualitetit të punëve e lëshuar nga një Bankë ose Kompani e Sigurimeve e licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës, me afat të validitetit për kohëzgjatjen e periudhës prej 25 muaj, duke filluar nga data e pranimit teknik të punëve.** |
| Pagesa pas shkëputjes së kontratës | 39.1 | Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është : përqindja e vlerësuar e punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara. |
| Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve | 42.2 | Konform nenit 42 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës. |
| Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore | 43.1 | a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet **në Gjykatën Komerciale në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, në pajtim me ligjin në Kosovë.** |

LOT 1

Shënim: Te përshkrimi i çmimeve duhet plotësuar vetëm kolonat F dhe G. Në kolonën F ju duhet të plotësoni duke shkruar normenë e TVSH-së, vetëm si numër 0, 8, apo 18, e jo në formatin ~~0%, 8% apo 18%,~~ Ndërsa në kolonën G, duhet ta plotësoni me çmimin për njësi me TVSH, po ashtu çmimin duhet ta shkruani me dy numra pas presëjes dhjetore

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Vërejtje: Çmimi për çdo pozicion duhët të përfshijë: Blerjën, furnizimin,transportin, punimin dhe montimin, lidhjet sjelljen e pozicionit ne gjendje plotësisht** | | | | | | | | |
| Nr. | Përshkrimi i pozicioneve | Njësia Matëse | Sasia | Çmimi për njësi pa TVSH | Norma e TVSH-së në % | Çmimi për njësi (me TVSh)-€ | Totali (Pa TVSH) | TVSH | Totali (me TVSH)-€ |
| | **Rehabilitimit të rrugëve në fshatrat: Arkashtic - Balinc L=4060m'b=5-4m'** | | | | | | | | |
| **1** | **PUNET PARAPRAKE NE TEREN** | | | | | | | | |
| 1.1 | Mobilizimi dhe rregullimi i punishtes për punë Ndërtimi i punishtës që përfshinë:<br>a) Zyra e përkohshme e ndërmarrjës më së paku 2 ndarje, secila ndarje duhet të ketë së paku sipërfaqe S=12m2, me nyje sanitare si dhe e kyçur në furnizimin me energji të pandërprerë elektrike dhe të ujit. Zyra duhet të ketë lidhje në kanalizimin publik funksional ose në një rezervuar ekologjik mobil<br>b) Zyra për organin mbikqyrës (minimum S=16m2), një tavolinë pune me minimum 6 karriga pune për gjatë gjithë kohës së ndërtimit<br>c) ëC ekologjike mobile për stafin punues eksekutiv për gjatë gjithë kohës së ndërtimit<br>d) Furnizimi i zyrës me lidhje për komunikim: telefon, faks dhe internet për gjatë gjithë kohës së ndërtimit | komplet | 1.00 | 423.73 | 18.00 | 500.00 | 423.73 | 76.27 | 500.00 |
| 1.2 | Kontrollimi dhe evdentimi i instalimeve nëntoksore, zgjidhja e problemeve eventuale që lidhen me planin operativ të ndërtimit si dhe përpilimi I planit detal operativ që lidhet më procesit të rehabilitimit . Në çmim të llogaritet edhe kosto eventuale e furnizimit të banorëve të prekur nga ndërtimi më të gjitha shërbimet publike: ujë sanitar, rrymë elektrike, largim të ujrave fekale. | m' | 4060.00 | 0.85 | 18.00 | 1.00 | 3440.68 | 619.32 | 4060.00 |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.3 | Vendosja e shenjave të përkohshme vertikale dhe shenjave për kontrollë të trafikut gjatë kryerjës së punimeve dhe sigurimi i komunikacionit gjatë punimeve në zgjërimet e rruges. | m' | 4060.00 | 0.85 | 18.00 | 1.00 | 3440.68 | 619.32 | 4060.00 |
| 1.4 | Shenimi i trasesë, si dhe percjellja e punimeve gjeodezike gjatë ekzekutimit | m' | 4060.00 | 5.00 | 18.00 | 5.90 | 20300.00 | 3654.00 | 23954.00 |
| **2** | **PASTRIMI I TERENIT** | | | | | | | | |
| 2.1 | Dislokimin e shtyllave ekzistuese te drurit dhe zevendesimin e tyre me shtylla te betonit me lartesi H=9m kendore tip 40° , me bazament te betonit duke perfshire germimin per bazament me dimensione (1.0x1.0x1.5)m, vendosjen e betonit , shiritin e tokezimit Fe/Zn 25x4mm (3.5m), reren e imet , montimi i unazes , vendosja e konzolles (per rrjet ajror 0.4kV) , trupave ndricues (nese ekzsiton) si dhe demontimi dhe montimi i serishem i kabllove ekzistuese ajrore dhe nentokesore eventuale dhe materiali tjeter i nevojshem komplet me ateste per nje shtylle te dislokuar. | copë | 8.00 | 50.85 | 18.00 | 60.00 | 406.78 | 73.22 | 480.00 |
| 2.2 | Prerja e shkurave dhe drunjnjeve , materjali I gërmuarë t ë ngarkohet dhe transportohet n ë vendin e caktuarë , operatori duhet të bëjë prerjen , coptimi në copza jo më t ë gjata se 5cm ( me makneri leveizese ) | m' | 1200.00 | 2.54 | 18.00 | 3.00 | 3050.85 | 549.15 | 3600.00 |
| 2.3 | Thyerja coptimi i shtresës se asflatit dhe nënbazës I materjali I gërmuarë të ngarkohet dhe transportohet në vendin e caktaurë nga investitori | m² | 19100.00 | 0.85 | 18.00 | 1.00 | 16186.44 | 2913.56 | 19100.00 |
| 2.4 | Gërmimi I kanlit në formë trapezi nga të anët e rrugës me diemnsion 55x120cm , materjali I gërmuarë të ngarkohet dh e transportohet n ë vendin e caktauar ë nga org. mbikqyrës | m' | 3700.00 | 0.85 | 18.00 | 1.00 | 3135.59 | 564.41 | 3700.00 |
| **3** | **PUNËT TOKËSORE** | | | | | | | | |
| 3.1 | Gërmimi i dheut i kategorisë së II- III- IV-V të me ngarkim dhe bartje deri në deponi në largësi min 15km. | m³ | 7177.63 | 0.68 | 18.00 | 0.80 | 4866.19 | 875.91 | 5742.10 |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 3.2 | Punimi i mbushjes me material guror fraksion 0-150për nivelizim me bartje, shtrirje në shtresa dhe ngjeshje 40 MN/m2 me CBR>5%.Materiali sipas profilave terthor. | m³ | 618.00 | 5.08 | 18.00 | 6.00 | 3142.37 | 565.63 | 3708.00 |
| **4** | **PUNËT E STRUKTURAVE LESHESAVE** | | | | | | | | |
| 4.1 | Furnizimi dhe montim te gypave nga betonarmeja Ø400mm L=7m' per qarkullim te ujit nga Kanali pergjatë rrugës .Ne qmim te kalkulohen germimi i dheut me largim, mbulim me zhavor (0-31.5) dhe kokat hyrese dhe dalese me beton C-25/30 Armatura rrjet Ø8-10/10cm. | copë | 4.00 | 127.12 | 18.00 | 150.00 | 508.47 | 91.53 | 600.00 |
| 4.2 | Furnizimi me materjal dhe ngritja e pusetave të kanalizimit fekal ,përfshirë furnizimin e kapakve të pusetave ng a materjali kompozit me aftësi mbajtëse 40t dhe punët tjera deri në funksionalizim | copë | 4.00 | 84.75 | 18.00 | 100.00 | 338.98 | 61.02 | 400.00 |
| 4.3 | Furnizimi me materjal dhe montimi I kapkve të pusetave të kanlizimit fekal me d=80cm nga materjali kompozit me aftesi mbajtese 40t në këtë pozcionë të përfshihen të gjitha punëte demolimit dhe atyre te montimi sipas standardeve | copë | 4.00 | 101.69 | 18.00 | 120.00 | 406.78 | 73.22 | 480.00 |
| 4.4 | Transporti, furnizimi dhe punimi i parmakeve metalik ( tubat kryesor prej celiku me diamter 6cm dhe me trashësi t=3mm, ndersa mbushjet me diameter 6cm dhe trashesi t=3mm, te gjithë tubat e celikut duhet te lyhen me dy shtresa anti korrozion dhe me ngjyre te metalit. | m' | 42.00 | 33.90 | 18.00 | 40.00 | 1423.73 | 256.27 | 1680.00 |
| 4.5 | Furnizimi ,kallupimi dhe betonimi i mureve, thmeleve ,pllakes shtyllave ballore me krihë, trareve, soletes kaluese, pllakave kapërcyese te klases C-30/37. Në cmimi hyn edhe edhe mirmbajtja | m³ | 45.78 | 118.64 | 18.00 | 140.00 | 5431.53 | 977.67 | 6409.20 |
| 4.6 | Furizimi, transporti, prerja dhe montimi I armtures Φ8,10,12,14 | kg | 5493.60 | 0.85 | 18.00 | 1.00 | 4655.59 | 838.01 | 5493.60 |
| 4.7 | Pastrimi I lëshesave egzistues, të bëhet sipas urdhrave të org, mbikqyrës duke përdorura pompa me presion dhe pastrimi me goma shtytse | m' | 5.00 | 21.19 | 18.00 | 25.00 | 105.93 | 19.07 | 125.00 |
| **5** | **KONSTRUKSIONI I TRASËS SË RRUGËS** | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 5.1 | Punimi, rrafshimi i nënbazës me ngjeshje (70MN/m²) me cilinder vibracion I pershtatshem per pozicionet ne kete rrugë. | m² | 22400.00 | 5.00 | 18.00 | 5.90 | 112000.00 | 20160.00 | 132160.00 |
| 5.2 | Furnizimi transporti dhe shtrirja e shtresës se materiali mbushes zhavori (0-125) mm me trashësi t=40cm apo ma shum sipas nevoje me ngjeshje 40 MN/m² me cilinder me vibracion (Ky materil perdoret ne vende jo stabile te trases)-Sipas nevojës | m³ | 3572.80 | 5.08 | 18.00 | 6.00 | 18166.78 | 3270.02 | 21436.80 |
| 5.3 | Punimi i tamponit (70MN/m²) prej gurit të thyer gëlqeror 0-63 mm në rrugë dhe trotuar me trashësi sipas detaleve dhe profilave terthor. | m³ | 1786.40 | 7.63 | 18.00 | 9.00 | 13625.08 | 2452.52 | 16077.60 |
| 5.4 | Punimi i tamponit (90MN/m²) prej gurit të thyer gëlqeror 0-31.5mm në rrugë dhe trotuar me trashësi sipas detaleve dhe profilave terthor. | m³ | 893.20 | 10.17 | 18.00 | 12.00 | 9083.39 | 1635.01 | 10718.40 |
| 5.5 | Furnizimi, transporti, vendosja dhe betonimi I skajoreve 18/24/100 cm .Skajoret do te punohen pergjat asfaltit dhe trotuarit.<br>Verejtje : Ne pjesen e kyqjeve te shtepive dhe rrugeve skajoret dhe trotuari duhet te jet me te ulta per kyqjen sa me te lehte ne rruge . | m' | 2850.00 | 11.02 | 18.00 | 13.00 | 31398.31 | 5651.69 | 37050.00 |
| 5.6 | Furnizimi, transporti, vendosja dhe betonimi i skajorëve 8/20/100 cm. Skajoret do te punohen pergjat trotuartit.<br>Verejtje : Ne pjesen e kyqjeve te shtepive dhe rrugeve skajoret dhe trotuari duhet te jet me te ulta per kyqjen sa me te lehte ne rruge . | m' | 2850.00 | 8.47 | 18.00 | 10.00 | 24152.54 | 4347.46 | 28500.00 |
| 5.7 | Furnizimi, transporti dhe shtrirja e shtresës së fundit të reres , fraksion 0-8 mm me trashësi të shtresës d=5cm. Në çmim te përfshihet edhe planifikimi i shtresës me saktësi ±1 cm. Sasia e llogaritur është për masën e ngjeshur të materialit | m³ | 200.00 | 11.02 | 18.00 | 13.00 | 2203.39 | 396.61 | 2600.00 |
| 5.8 | Furnizimi, transporti dhe shtrirja shtresës komunikuese ne trotuare nga kubzat e betonit me trashesi prej 8 cm MB40 , ngjeshja e tyre dhe punimi I fugave. Forma dhe dimensionet e cakton organi mbikqyres. | m² | 4000.00 | 11.02 | 18.00 | 13.00 | 44067.80 | 7932.20 | 52000.00 |
| 5.9 | Punimi i tamponit prej gurit të thyer gëlqeror 0-31.5mm në bankinat e rrugës trashësi 10-15cm. | m³ | 487.20 | 10.17 | 18.00 | 12.00 | 4954.58 | 891.82 | 5846.40 |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 5.10 | Furnizimi dhe punimi i shtresës së bitoagregatit 0-22CS mm me trashësi t=8cm | m² | 19100.00 | 11.86 | 18.00 | 14.00 | 226610.17 | 40789.83 | 267400.00 |
| 5.11 | Furnizimi ,transporti,dhe lyerja me emulzion e shtreses se asfaltit me emuzion mbi shtresen e bitoagregatit dhe shtreses ekzistuese te asfalltit te grryer. | m² | 19100.00 | 2.12 | 18.00 | 2.50 | 40466.10 | 7283.90 | 47750.00 |
| 5.12 | Furnizimi dhe punimi i asfaltit betonit 0-16S mm me trashësi t=7cm ne zgjerime.Ne çmim te kalkulohen edhe testet marshall sipas standardeve për ketë pozicion.<br>Te sillen atestet e nevojshme. | m² | 19100.00 | 10.17 | 18.00 | 12.00 | 194237.29 | 34962.71 | 229200.00 |
| 5.13 | Furnizimi dhe punimi në rrugë i vijës ndarëse të ndërprere dhe të pa nderprerë të shiritave të qarkullimit nga masat e perziera termoplastike me gjerësi 12cm vijë e bardhë, ku klasa e retro-refleskionit duhet të jetë R4 (Rl≥200mcd / lx / m2), koeficienti i fraksionit i clases me S2 ndërsa faktori i shkëlqimit (reflektimit) B4, me perberje te grimcave fluroscente me trashesi prej 3mm | m' | 4060.00 | 0.42 | 18.00 | 0.50 | 1720.34 | 309.66 | 2030.00 |
| 5.14 | Furnizimi dhe punimi në rrugë i vendkalimeve për këmbësor të punohen me dorë ose makinë, nga masat e perziera termoplastike, ku klasa e retro-refleskionit duhet të jetë R4 (Rl≥200mcd / lx / m2), koeficienti i fraksionit i clases me S2 ndërsa faktori i shkëlqimit (reflektimit) B4, me perberje te grimcave fluroscente me trashesi prej 3mm | m² | 75.00 | 4.24 | 18.00 | 5.00 | 317.80 | 57.20 | 375.00 |
| 5.15 | Shqyrtimi i provave për të gjitha shtresat e rruges në laborator sipas kërkeses së investitorit (Nënbazës, shtresës stabilizuese dhe shtresave të asfaltit etj..). Po ashtu duhet të sigurohen të gjitha atestet për materiale të kërkuar nga organi mbikqyrës. | copë | 20.00 | 16.95 | 18.00 | 20.00 | 338.98 | 61.02 | 400.00 |
| 5.16 | Furnizmimi me materjal dhe sinjalizimi - vendosja e shenjave vertikale të punuara nga alumin dhe hekri I zinguarë të vendosura në teren sipas standardeve | copë | 6.00 | 50.85 | 18.00 | 60.00 | 305.08 | 54.92 | 360.00 |
| | **NENTOTALI I** | | | | | | **794,911.95** | **143,084.15** | **937,996.10** |

| IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE) | |
|---|---|
| **EMRI I OE:** | NPSH BAGERI |
| **EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TË OE:** | Bujar Shabani |
| **NËNSHKRIMI:** | |
| **DATA:** | 16.09.2024 |
| **VULA:** | |